



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	02.05.2024
REFERENC-Ë:	23/3285/ MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Eu Beton" Sh.p.k. Fushë Kosovë, fabrikë për prodhimin e llaqeve, fasadave, ngjitësve dhe bluarjen e gurit gëlqeror, Harilaq, Fushë Kosovë
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "Eu Beton" Sh.p.k. Fushë Kosovë me nr. prot. 23/4285/MMPHI, fabrikë për prodhimin e llaqeve, fasadave, ngjitësve dhe bluarjen e gurit gëlqeror, Harilaq, Fushë Kosovë.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

1. Vendimi për Leje Mjedisore për operatorin: "Eu Beton" Sh.p.k. Fushë Kosovë, për veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin e llaqeve, fasadave, ngjitësve dhe bluarjen e gurit gëlqeror, Harilaq, Fushë Kosovë.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 23/4285/MMPHI
Datë: 02.05.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatori "Eu Beton" Sh.p.k. Fushë, pajiset me Leje Mjedisore për veprimtarinë: fabrikë për prodhimin e llaqeve, fasadave, ngjitësve dhe bluarjen e gurit gëlqeror, Harilaq, Fushë Kosovë nr. prot. 23/4285/MMPHI
2. Operatori obligohet:
 - 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
 - 2.2. Të monitorohet në vazhdim emisionet në ajër dhe të raportohet në MMPHI, sipas legjislacionit në fuqi.
 - 2.3. Mbetjet nga procesi teknologjik, të vendosen në hapësirë të betonuar dhe izoluar, ose të vendosen në kontejner të mbyllur;
 - 2.4. Sistemi de-pluhurues të jetë funksional;
 - 2.5. Të bëhet kontrolli i rregullt i makinerisë, për parandalimin e rrjedhjeve të karburanteve;

- 2.6. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit te mjedisit që është përgjegjës për mjedis;
- 2.7. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI;

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin është konstatuar se N.P.T." GRAN-STYRO", Sh.p.k, Landovicë Prizren, për veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin e styroporit në ngastrën, nr.993-2, zona kadastrale, Landovicë, Prizren, plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për Leje Mjedisore.


Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr. 21/1220/1-ZSP/21, të lëshuar me datë: 12.05.2021
- Njoftim mbi destinimin nga Drejtoria e Planifikimit Urban, F.Kosovë Dokument, me nr.: 311, të datës: 21.08.2019;
- Raporti i analizave të pluhurit total të depozituar dhe gazrave nga Laboratori INKOS, sh.a, me nr.prot. 208 të dt. 15.06.2023;
- Pëlqim nga AME, nr.0002986/23 , të lëshuar me datë: 06.10.2023

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr **Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.**

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Fushë Kosovë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së